



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02. Nr. 166 -22

Data: 16.12.2022

Komuna e Mamushës

Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa			
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing			
02	No.Nr.	<u>166</u> - <u>22</u>	
Tarih/Dt.		<u>16. 12. 2022</u>	

Duke u bazuar në nenit 13 dhe 58 pika (h) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr./L-040, neni 82.7 statutit të Komunës së Mamushës të dates 01.12.2008 Ligjit për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, dhe marrë parasysh Prishjen e rendit dhe qetësisë publike në prag të festave të fund vitit Kryetari i Komunës së Mamushës mori këtë:

V E N D I M

Për ndalimin e përdorimit dhe shitjes së paautorizuar të mjeteve piroteknike

I

NDALOHET: Ndezja dhe përdorimi i fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike në hapësirat publike, përkatësisht në shkolla, rrugë, sheshe, afërsi të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe zona të banuara, si dhe shitja nga personat e paautorizuar.

II

LEJOHET: Përdorimi dhe shitja e mjeteve piroteknike vetëm nga data: **31.12.2022** prej orës **19:00** deri në ora **00:30** të datës **01.01.2023** me kusht që përdorimi i tyre të bëhet në mënyrë të organizuar dhe kontrolluar në qendër të Komunës.

II

Shitja e mjeteve Piroteknike përcaktohet me kushtet teknike për objektet të cilat përdoren për shitjen me pakicë të fishekzjarrëve dhe mjeteve tjera piroteknik, e cila rregullohet me **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 14/2013.**

III

OBLIGOHET: Drejtoria e Inspektoratit, që në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës- Stacioni Policor në Mamushë, të ndërmarin të gjitha masat masat e nevojshme ndaj shkelësve eventual të kësaj ndalese.

IV

Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe fillon së zbatuari nga data: **16.12.2022**

Njoftohen:

1. Drejtoria e Inspektoratit
2. Stacioni Policor në Mamushë
3. Kopje në tabelën e shpalljes
4. Arkivi

16.12.2022

Kryetari i Komunës

Abdullahi Krasniq

